

VENDIM
Nr.47, datë 27.1.2006

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.205, DATË 13.4.1999 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR DISPOZITAT ZBATUESE TË KODIT DOGANOR”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 3 të nenit 32 të ligjit nr.8449, datë 27.1.1999 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr.205, datë 13.4.1999 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, shkronjat “a”-“h” të pikës 49.3 shfuqizohen dhe zëvendësohen me shkronjat “a”-“1”, si më poshtë vijon:

“a) operacione ruajtjeje, për të siguruar se produktet do të vazhdojnë të jenë në kushte të mira gjatë transportit dhe magazinimit;

b) thyerja dhe bashkimi i paketimeve;

c) larja, pastrimi, heqja e pluhurit, e oksideve, vajit, bojës apo mbulimeve të tjera;

ç) hekurosjë apo presimi i tekstileve;

d) operacione të thjeshta lyerjeje dhe ndriçimi;

dh) shoshitja, bluarja e pjesshme apo e përgjithshme, ndriçimi dhe shkëlqimi i farërave dhe i orizit;

e) operacione për të ngjyrosur sheqerin apo për të krijuar forma sheqeri, bluarje të pjesshme apo të plotë të sheqerit;

ë) heqja e lëkurës, ngurtësimi dhe veshja e frutave, arrave dhe perimeve;

f) mprehja, prerja e thjeshtë apo thelëzimi i thjeshtë;

g) ndarja, përzgjedhja, mbulimi, klasifikimi, gradimi, ngjasimi (duke përfshirë krijimin e kompleteve të mallrave);

gj) vendosja e thjeshtë në shishe, konserva, faqore, çanta, kuti, ngjitja e kartave apo e mbështjellësve dhe të gjitha operacionet e tjera të thjeshta të paketimit;

h) ngjitja apo printimi i treguesve, etiketave, logove dhe shenjave të tjera të ngjashme, dalluese, mbi produktet apo paketimet e tyre;

i) përzierja e thjeshtë e produkteve, duke qenë ose jo të llojeve të ndryshme, kur një apo më tepër përbërës të përzierjes nuk përmbushin kriteret e paraqitura në këtë seksion, për t’u mundësuar atyre të vlerësohen si të origjinës në një vend përfitues, në një territor ose në komunitet;

j) bashkimi i thjeshtë i pjesëve të mallrave, për të përbërë një material të plotë ose ndarje të produkteve në pjesë;

k) një kombinim i dy ose më tepër operacioneve të specifikuar në shkronjat “a” deri në “j”;

l) therrja e kafshëve.”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha